



## Rivendoset nga Bashkia e Tiranës busti i De Radës në 200-vjetorin e lindjes

*Shkrimtari Ismail Kadare ka thënë në vitin 1964 se “De Rada u kthye në pallatin e poezisë si një vajzë e freskët, por e belbët, sepse atdheu i tij në atë kohë ishte i humbur”*

### Denion Ndrenika

Në 200-vjetorin e lindjes, Bashkia e Tiranës riktheu në kryeqytet një bust të rilindasit arbëresh Jeronim de Rada.

Ceremonia u zhvillua paradreke me vendosjen e bustit të punuar nga Artisti i Popullit, skulptori Odise Paskali pas disa viteve që Bashkia thotë se “është lënë në harresë”.



Studiuesi Ndrëçim Kulla tha se Jeronim de Rada konsiderohet si rilindësi i parë ose si themelues i Rilindjes tonë evropiane:

“Si një publicist dhe studiues, gjithmonë i kam mëshuar idesë tek rikthimi tek rrënjët, sepse rikthimi tek rrënjët nuk duhet të jetë një formalitet, por është diçka emancipuese dhe diçka e shëndetshme për shpirtin e gjithsecilit”.

“Ne, – vijoi publicisti Kulla, – sot po kujtojmë, ose po i bëjmë më mirë homazhe një personaliteti shumë të njohur të kulturës sonë kombëtare, Jeronim De Radës”-tha ai.

Në një njoftim të zotit Basha në profilin e tij në fejsbuk, citohet shkrimtari Ismail Kadare të ketë thënë në vitin 1964:

“De Rada u kthye në pallatin e poezisë si një vajzë e freskët, por e belbët, sepse atdheu i tij në atë kohë ishte i humbur”.

De Rada ishte protagonistin kryesor, i cili i bëri të qartë Europës se Shqipëria ishte një vend fisnik, me sentimente të larta njerëzore të pakrahueshme edhe me kombe të tjerë, – vijon njoftimi, – dhe ishte një vend që kishte heronj si Skënderbeu dhe heronj të tjerë që luftuan për vlerat e Europës që ne sot po aspirojmë të shkojmë si askush tjetër në rajonin e Ballkanit”.